



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT MUJOR

Drejtoria:	Drejtoria e Planifikimit Strategjik
Periudha raportuese:	<b>Muaji Qershor - 2023</b>
Emri dhe mbiemri i raportuesit:	Mimoza Sylejmani Drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik

#### PROJEKTET:

- **Projekti dhe paramasa e parkut, para librarisë “Dukagjini”;**
- **Dorëzimi i projektit konceptual për laborator, në ambulancën në Bardhosh;**
- **Vazhdimi i projektit për hapësirën publike në Ulpianë;**
- **Projekti i hapësirës publike në Ulpianë;**
- **Paramasa për sanimin e platove/urave, në Bregun e Diellit;**
- **Fillimi i punimeve në objektin e “Shoqatës të të shurdhërve”;**
- **Hartimi i projektit konceptual për Tregun e gjelbër;**
- **Parallogaria e punëve të fontanave në KRU;**
- **Ndryshimi i projektit për laboratorin e QMF - Bardhosh;**
- **Projekti i rampës për zyrën e mediave;**
- **Matjet për riorganizimin e toaleteve, në zyrat e mediave;**
- **Pjesa e planifikimit të PZHK-së në përfundim e sipër;**
- **Përditësimi i dokumentit të PZHK-së;**
- **Editimi/adoptimi i aksit të rrjetit rrugor në zonat rurale të Komunës së Prishtinës (detyrë për HZ);**
- **Përpunimi i fil-it të auto-udhëve që përkojnë kryeqytetin, për nevoja të Hartës Zonale;**
- **Krijimi i fil-eve për Drejtorinë e Investimeve Kapitale, PRRH Kalabria, Prishtina e Re - lindje, perëndim dhe qendër, Mati 1, Mati 3. Po ashtu edhe shtresëzimi i projekteve për rrugën A;**
- **Përditësimi i rrugës A, B dhe C, për nevoja të Hartës Zonale;**
- **Përditësimi i kërkesave të qytetarëve.**

## **AKTIVITETET:**

- Gjatë muajit qershor, në Sektorin e planifikimit janë trajtuar gjithsej 44 lëndë;
- Informimi i palëve për kriteret e planeve, në ditët e caktuara me palë;
- Është mbajtur intervista me kandidatët për pozitat e hapura në shërbimin civil, gjegjësisht në Sektorin e planifikimit strategjik;
- Caktimi i 2 lokacioneve për ndërtimin e institucioneve parashkollore, në fshatin Llukar dhe Busi.

## **TAKIMET:**

- Takim në prokurim për negocimin e kontratës, për projektin e Sallës koncertale;
- Takim me Kryetarin, për planifikimin e hapësirës për treg, përzgjedhja e inventarit për zyra, organizimi i zyrave në Komunën e re;
- Takim në kabinet, konsultë për projektin e tregut;
- Takim në MASHT, në lidhje me çerdhen në Dardani;
- Takim në Hortikulturë, diskutim rreth projekteve;
- Takim me Kryetarin, në lidhje me vendosjen e shtëpizave të drurit në hapësirën e Tregut;
- Takim në DIKMK me DMS për detyrën projektuese për QP;
- Takim pune me grupin punues, për hartimin e zgjidhjes urbane për Kampusin sportiv, në lagjen “Zona Ekonomike” në Prishtinë;
- Takime të rregullta me Kompaninë projektuese “GM Architects” lidhur me definimin dhe hartimin e Master - planit për rigjenerimin e lagjes Kodra e Trimave 2;
- Takim me grupin punues për Kampusin sportiv;
- Takim konsultativ me UN Habitat, MMPHI, MKRS, QRTK dhe përfaqësuesit e Komunës së Prishtinës, lidhur me kufirin e zonës historike të Prishtinës;
- Takim pune me grupin punues, për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për taksa dhe tarifa Komunale;
- Takim pune me grupin punues për hartimin e PRRH-së, të lagjes Kalabria në Prishtinë;
- Takim me përfaqësuesit e JICA, lidhur me nivelet e ndotjes dhe masat që janë marrë deri më tani;
- Takim konsultativ me përfaqësuesit e banorëve, të lagjes Mati 1, Blloku A11.

## **VIZITAT NË TERREN:**

- Terren në Bregun e Diellit, për vlerësimin e gjendjes ekzistuese të hapësirave që duhet sanuar;
- Terren në KRU, për analizimin e lokacionit për dizajnimin e fontanës;
- Vizitë në KRU, për rregullimin e fontanave;
- Vizitë në Termokos, për rregullimin e hapësirës publike, projekti për dizajnimin e fontanave;
- Vizitë në oborrin e ish-AKP-së, për riorganizimin e Tregut të gjelbër;
- Matjet për riorganizimin e toaleteve, në zyrat e mediave.

